PORSCHE
ALBANIA

DRIVE

QERSHOR 2025



20 VITE PORSCHE ALBANIA

Stafi i Porsche Albania feston 20 vite suksesi.
The Porsche Albania team celebrates 20 years of success.

ŠKODA ELROQ

Ju prezantojmë modelin më të ri 100% elektrik nga Škoda – Elroq.
Introducing the newest 100% electric model from Škoda – Elroq.


VOLKSWAGEN TAYRON

Tayron, modeli më i ri nga Volkswagen, mbërrin në Shqipëri.
The latest Volkswagen model, Tayron, has arrived in Albania.

MAKINA IME | PARK ON

ParkON – teknologjia që e bën parkimin më të thjeshtë se kurrë.
ParkON – making parking simpler than ever.





20 VITE PORSCHE ALBANIA

6

Stafi i Porsche Albania feston 20 vite suksesi.
The Porsche Albania team celebrates 20 years of success.

ŠKODA ELROQ

10

Ju prezantojmë modelin më të ri 100% elektrik nga Škoda – Elroq.
Introducing the newest 100% electric model from Škoda – Elroq.

VOLKSWAGEN TAYRON

20

Tayron, modeli më i ri nga Volkswagen, mbërrin në Shqipëri.
The latest Volkswagen model, Tayron, has arrived in Albania.

MAKINA IME | PARK ON

30

ParkON – teknologjia që e bën parkimin më të thjeshtë se kurrë.
ParkON – making parking simpler than ever.


UDHËTOJNA
20
VITE
PORSCHE
ALBANIA

20 VITE PORSCHE ALBANIA NJË HISTORI PËRKUSHTIMI, ZHVILLIMI DHE PASIONI PËR TË ARDHMEN



20 years of Porsche Albania a story of commitment, development and passion for the future

Viti 2025 shënon një moment historik për ne, 20 vite që Porsche Albania është pjesë e tregut shqiptar.
Janë 20 vite që nuk përkufizohen vetëm nga fakti që kemi sjellë disa prej brandeve më të fuqishme automobilistike në vend, por nga vlerat dhe angazhimi i përditshëm për të ndërtuar një standard të ri në tregun shqiptar, një standard që tregon cilësinë, integritetin, përgjegjësinë dhe respektin ndaj klientëve dhe punonjësve tanë.
Që nga themelimi në vitin 2005, Porsche Albania ka evoluar nga një kompani shitjeje makinash në një organizim moderne, pjesë e familjes së madhe të Volkswagen Group. Sot, përfaqësojmë zyrtarisht markat Volkswagen, Audi, SEAT, Škoda, Volkswagen Makina Tregtare, Das WeltAuto dhe kemi ndërtuar me përkushtim një ekosistem të qëndrueshëm dhe digjital, që përfshin gjithashtu platforma inovative si "Makina Ime", një ndër aplikacionet e krijuara dhe zhvilluara në Shqipëri që ka për qëllim edukimin, informimin dhe çdo gjë rreth lëvizjes.
Në këtë rrugëtim, nuk kemi qenë thjesht një distributor, por edhe një model për respektimin e standardeve ndërkombëtare të transparencës dhe etikës në biznes. Pajtueshmëria dhe integriteti kanë qenë gjithmonë në qendër të çdo vendimmarrjeje, duke ndërtuar besim jo vetëm me klientët, por edhe me partnerët dhe institucionet.
Po ashtu, kemi investuar vazhdimisht në zhvillimin e burimeve njerëzore, duke ndërtuar një kulturë pune që mbështet rritjen personale dhe profesionale të secilit punonjës.
Trajnimet, mundësitë e zhvillimit dhe fryma e bashkëpunimit kanë bërë që Porsche Albania të jetë sot një nga punëdhënësit më të kërkuar në treg.
Për të festuar këtë përvjetor të rëndësishëm, më 23 maj 2025, stafi i Porsche Albania u mblodh në një resort në Sarandë, për të reflektuar mbi këtë rrugëtim të jashtëzakonshëm, për të ndarë kujtime dhe për të shijuar një moment të merituar festimi. Ky event shënoi fillimin e një kalendari aktivitetesh që do të zgjasë gjatë gjithë vitit dhe që synon të përfshijë punonjësit, klientët, median dhe partnerët tanë më të rëndësishëm.
Vetëm pak ditë më pas, u organizua edhe një event zyrtar me përfaqësues të mediave kombëtare, ku ndamë jo vetëm arritjet tona, por edhe vizionin për të ardhmen: mobilitet të qëndrueshëm, digjitalizim dhe shërbime të personalizuara për çdo klient.
Nëse këto 20 vite kanë qenë histori e një angazhimi të sinqertë dhe të palëkundur, e ardhmja është ajo që na frymëzon më shumë. Si pjesë e Volkswagen Group, kemi përgjegjësinë të jemi jo vetëm në pararojë të inovacionit teknologjik, por edhe të transformimit kulturor dhe shoqëror, përmes projekteve që ndikojnë pozitivisht komunitetin, ambientin dhe brezat e ardhshëm.
Faleminderit çdo anëtari të ekipit që ka kontribuar në këtë histori.

Faleminderit klientëve tanë për besimin dhe partnerëve për mbështetjen.
20 vitet janë vetëm fillimi – më e bukura është ende përpara.

Gentian Bushati
Drejtor i Përgjithshëm, Porsche Albania

20 years of Porsche Albania in the Albanian market.
These two decades are defined not only by bringing some of the world's most iconic automotive brands to Albania, but by our daily commitment to building a new standard in the local market — a standard that reflects quality, integrity, responsibility, and respect for both our customers and employees.
Since its founding in 2005, Porsche Albania has evolved from a car sales company into a modern and future-driven organization, proudly part of the Volkswagen Group family. Today, we officially represent Volkswagen, Audi, SEAT, Škoda, Volkswagen Commercial Vehicles, and Das WeltAuto in Albania. With dedication and vision, we have built a sustainable and digital ecosystem, which includes innovative platforms such as "Makina Ime" — one of the first locally developed apps designed to educate, inform, and support every step of mobility and ownership for the Albanian driver.
Throughout this journey, we have aimed to be more than a distributor — we strive to be a model of transparency and international business ethics. Compliance and integrity have always been at the core of our decisions, building long-term trust not only with our customers but also with our partners, institutions, and communities.
We have also invested continuously in the development of our people, fostering a company culture that supports both personal and professional growth. Thanks to comprehensive training programs, career development opportunities, and a collaborative spirit, Porsche Albania is today one of the most sought-after employers in the market.
To commemorate this special anniversary, on May 23, 2025, the Porsche Albania team gathered in a seaside resort in Saranda, taking time to reflect on our journey, share memories, and celebrate this milestone together.
This event marked the beginning of a full-year celebration calendar, designed to bring together employees, customers, media representatives, and key partners across several dedicated initiatives.
Just a few days later, we hosted an official media event with national press representatives, where we shared not only our achievements but also our clear vision for the future: sustainable mobility, digital transformation, and personalized services for every customer.
If these first 20 years have been a story of honest dedication and unwavering growth, the future is what inspires us even more. As part of the Volkswagen Group, we carry the responsibility not only to lead through technological innovation but also to contribute to positive cultural and societal change — through projects that impact the environment, community, and the next generation.
To every member of our team who has contributed to this journey — thank you.
To our customers — thank you for your trust.
To our partners — thank you for your continued support.
20 years is just the beginning — the best is yet to come.

Gentian Bushati
General Manager, Porsche Albania

PJESË E PORSCHE ALBANIA NË 20-VJETORIN

Part of Porsche Albania in the 20th annyversary



Është me të vërtetë domethënëse për mua që iu bashkova Porsche Albania pikërisht gjatë vitit të 20-vjetorit të saj, duke qenë pjesë e një momenti kaq të rëndësishëm në udhëtimin e kompanisë.
Duke pasur mundësinë të përjetoj kultura të ndryshme brenda organizatave të Porsche Holding Salzburg, mund të them me bindje se Porsche Albania është diçka vërtet e veçantë. Që në kohën e shkurtër që jam këtu, kam qenë dëshmitar i energjisë, integritetit dhe frymës së bashkëpunimit që përshkruajnë kulturën e kësaj kompanie.
Që në janar, u ndesha për herë të parë me sloganin e 20-vjetorit: "Udhëtojna." Fillimisht ishte thjesht një fjalë, por sapo kuptova domethënien e saj, më preku si një shprehje kreative dhe simbolike e udhëtimit që kjo kompani ka bërë. Ajo çast më ngjalli kuriozitet dhe më shtyu të vlerësoj më thellë fushatën, njerëzit dhe historinë që qëndron pas Porsche Albania.
Që atëherë, kam pasur privilegjin të marr pjesë në disa aktivitete dhe nisma që jo vetëm nderuan arritjet e 20 viteve të fundit, por edhe reflektuan shpirtin e unitetit, qëndrueshmërisë dhe ambicies që shtyn këtë ekip përpara. Nga fillimi me vetëm 10 pionierë, Porsche Albania është rritur në një ekip prej 78 profesionistësh të përkushtuar në Departamentin e Shitjeve, Pas-shitjes, Burimeve Njerëzore, Përputhshmërisë & Ligjit, Marketingut, Financës, Logjistikës dhe IT-së, secili duke kontribuar në një mision të përbashkët: të vendosim standarde, të tejkalojmë pritshmëritë dhe të krijojmë vlerë afatgjatë.
Ajo që më frymëzon më shumë është se rritja e Porsche Albania është ngushtësisht e lidhur me vlerat thelbësore të Grupit Volkswagen. Kjo është një kompani ku integriteti, transparenca dhe standardet e larta nuk janë thjesht fjalë, ato jetohen çdo ditë. Kultura jonë e përputhshmërisë nuk ka të bëjë vetëm me ndjekjen e rregullave, por me ndërtimin e besimit me klientët tanë, institucionet dhe njëri-tjetrin.
Po aq mbresëlënëse është edhe përkushtimi i kompanisë ndaj zhvillimit të burimeve njerëzore. Kam parë nga afër investimin që bëhet për të kultivuar talentin, për të ofruar trajnim të vazhdueshëm dhe për të ndërtuar një ambient pune ku njerëzit ndihen të vlerësuar, të mbështetur dhe të fuqizuar për të rritur potencialin e tyre. Kjo është një ndër arsyet pse Porsche Albania është një nga punëdhënësit më të admiruar në treg dhe pse ekipi ynë vazhdimisht arrin rezultate të forta dhe kënaqësi të lartë të klientëve.
Në të njëjtën kohë, jemi duke përqafuar transformimin digjital, si në mënyrën se si operojmë, ashtu edhe në mënyrën se si i shërbejmë klientëve tanë. Nisma si "Makina Ime," e zhvilluar këtu në Shqipëri, tregojnë përkushtimin tonë ndaj inovacionit dhe kuptimin e qartë që kemi për çfarë përfaqëson mobiliteti modern sot.
Ndërsa reflektoj mbi këto gjashtë muaj të fundit, ndiej krenari dhe entuziazëm. Krenari për gjithçka që ky ekip ka arritur gjatë dy dekadave të fundit dhe entuziazëm për atë që na pret përpara. Sepse nëse ka një gjë që kam mësuar, është se Porsche Albania nuk i feston vetëm arritjet por i përdor ato si pika nisjeje për udhëtimin e radhës.
Jam vërtet i nderuar që jam pjesë e këtij ekipi dhe që punoj përkrah kolegëve që janë të përzemërt, pasionantë dhe të bashkuar nga një qëllim i përbashkët: të bëjnë Porsche Albania edhe më të ndritur dhe të suksesshme.

Robert Herzog
Drejtor i Përgjithshëm, Porsche Albania

It feels truly meaningful to have joined Porsche Albania during its 20th anniversary year and to be part of such a significant milestone in the company's journey.
Having had the opportunity to experience many organizations within Porsche Holding Salzburg, I can confidently say that Porsche Albania stands out as something truly special. In just a short time, I've witnessed the energy, integrity, and teamwork that define this company's culture.
Back in January, I first encountered the anniversary slogan "Udhëtojna." At first, it was just a word but once I understood its meaning, it struck me as a creative and symbolic expression of the journey this company has taken. That moment sparked my curiosity and led to a deeper appreciation for the campaign, the people, and the story behind Porsche Albania.
Since then, I've had the privilege of participating in several celebrations and initiatives that not only honored the achievements of the past 20 years but also reflected the spirit of unity, resilience, and ambition that drives this team forward. From its beginnings with just 10 pioneers, Porsche Albania has grown into a team of 78 dedicated professionals across Sales, After Sales, HR, Compliance & Legal, Marketing, Finance, Logistics and IT, each contributing to a shared mission: to set standards, exceed expectations, and create long-term value.
What inspires me most is how Porsche Albania's growth is so closely aligned with the core values of the Volkswagen Group. This is a company where integrity, transparency, and high standards are not just words, they are lived every day. Our compliance culture is not merely about following rules, it's about building trust with our clients, institutions, and each other.
Equally impressive is the company's commitment to HR development. I've seen firsthand the investment in nurturing talent, providing continuous training, and fostering a workplace where people feel seen, supported, and empowered to grow. This is a key reason why Porsche Albania is one of the most admired employers in the market—and why our team consistently delivers strong results and customer satisfaction.
At the same time, we are embracing digital transformation, both in how we operate and how we serve our customers. Initiatives like "Makina Ime," developed right here in Albania, show our dedication to innovation and our understanding of what modern mobility means today.
As I reflect on these past six months, I feel both proud and excited. Proud of what this team has accomplished over the past two decades—and excited for what lies ahead. Because if there's one thing I've learned, it's that Porsche Albania doesn't just celebrate milestones, it uses them as starting points for the next journey.
I'm truly honored to be part of this team and to work alongside colleagues who are warmhearted, passionate, and united by a common goal: to make Porsche Albania even brighter and more successful.

Robert Herzog
General Manager, Porsche Albania

20 VITE BASHKË, PORSCHE ALBANIA FESTON NË SARANDË ME NJË STAFF RETREAT TË DEDIKUAR

20 years together, Porsche Albania celebrates in Saranda with a dedicated Staff Retreat

Në kuadër të përvjetorit të 20-të të **Porsche Albania**, u organizua një **Staff Retreat i unik në Sarandë**, një nga destinacionet më të bukura bregdetare të Shqipërisë. Ky aktivitet u konceptua për të festuar rrugëtimin e kompanisë dhe për të vlerësuar njerëzit që e kanë ndërtuar atë ndër vite, duke krijuar një moment të veçantë për të gjithë ekipin.

Në një atmosferë të ngrohtë dhe energjike, pesë kolegë të fantastik u nderuan për kontributin dhe besnikërinë e tyre shumëvjeçare. **Bledar Kozma, Engjell Mehmetaj, Ramiz Aliaj, Ilirjan Milla** dhe **Arven Flamuraj** kanë mbushur 20 vite punë pranë Porsche Albania, duke u bërë shembull frymëzues për profesionalizëm dhe përkushtim.

Ky Staff Retreat shërbeu gjithashtu si një mundësi për të mirëpritur kolegët e rinj që i janë bashkuar së fundmi familjes së Porsche Albania. Përmes aktiviteteve të ndryshme u krijua një hapësirë ku anëtarët e rinj dhe ata me eksperiencë ndanë përvojat e tyre, duke forcuar frymën e bashkëpunimit dhe të ekipit.

Eventi ishte më shumë se një festë, ishte një udhëtim simbolik që rikujtoi rrënjët tona dhe theksoi vlerën e çdo individi në ndërtimin e së ardhmes së përbashkët.

Porsche Albania falënderon të gjithë ekipin për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm dhe mirëpret me krenari çdo anëtar të ri që i bashkohet këtij komuniteti që ecën përpara, gjithmonë së bashku.

As part of **Porsche Albania**'s 20th anniversary, a dedicated **Staff Retreat was organized in Saranda**, one of Albania's most beautiful coastal destinations. The event was designed to celebrate the company's journey and to honor the people who have built it over the years, creating a special moment for the entire team.

In a warm and dynamic atmosphere, five outstanding colleagues were recognized for their long-standing contribution and loyalty. **Bledar Kozma, Engjell Mehmetaj, Ramiz Aliaj, Ilirjan Milla,** and **Arven Flamuraj** have completed 20 years of service with Porsche Albania, serving as inspiring examples of professionalism and dedication.

The Staff Retreat also served as a great opportunity to welcome new colleagues who have recently joined the Porsche Albania family. Through a variety of activities, both new and experienced team members shared their experiences, strengthening the spirit of collaboration and teamwork.

The event in Saranda was more than a celebration , it was a symbolic journey that reminded us of our roots and highlighted the value each individual brings to building our shared future.

Porsche Albania extends its heartfelt thanks to all team members for their exceptional contributions and proudly welcomes every new member who joins this community that moves forward, always together.


UDHËTOJNA


UDHËTOJNA



PORSCHE ALBANIA SHPALL KONKURSIN ARTISTIK PËR 20-VJETORIN

Porsche Albania launches art competition for its 20th anniversary

Me rastin e 20-vjetorit të Porsche Albania, kompania shpall një **konkurs artistik** të hapur për krijimin e instalacionit më të bukur publik, si një bashkëbisedim mes artit, qytetit dhe ADN-së së markës.

Këtë vit materialet e përdorura do të jenë të gjitha të ricikluara, duke sjellë një dimension të ri krijimtarie që ndërthur kujdesin ndaj mjedisit me transformimin estetik.

Ky konkurs fton artistët dhe krijuesit shqiptarë të interpretojnë përmes veprave të tyre frymën e progresit, inovacionit dhe lirisë urbane, vlera që kanë përshkuar rrugëtimin e Porsche Albania për dy dekada.

Të gjitha veprat finaliste do të prezantohen në një ekspozitë publike të hapur, që do të zhvillohet gjatë eventit të shpalljes së fituesve, organizuar nga Porsche Albania. **Instalacioni fituese do të instalohet në një hapësirë publike në Tiranë**, ku do të qëndrojë si simbol i përhershëm i ndërthurjes së artit me teknologjinë, përkujdesje dhe komunitetin.

Ky projekt më shumë se një konkurs: është një reflektim mbi ripërdorimin, një nxitje për dialog estetik dhe një dëshmi e angazhimit të Porsche Albania për të sjellë artin bashkëkohor më pranë publikut shqiptar aty ku qyteti frymon.

On the occasion of its 20th anniversary, Porsche Albania announces an **open art competition** for the creation of Tirana's most beautiful public installation, a dialogue between art, the city, and the brand's legacy.

This year, in a bold creative shift, all materials used will be recycled from Porsche Albania's own service center, adding a powerful environmental and artistic dimension to the competition.

The initiative invites Albanian artists and creators to interpret through their work the spirit of progress, innovation, and urban freedom, values that have defined Porsche Albania's journey over the past two decades.

All finalist and winning works will be showcased in a curated public exhibition, held during the official winners' announcement event hosted by Porsche Albania. **The winning installation will be permanently placed in a public space in Tirana**, standing as a lasting symbol where art, technology, care, and community converge.

This project is more than a competition: it is a statement on reuse, an invitation for aesthetic dialogue, and a reflection of Porsche Albania's continued commitment to bringing contemporary art closer to the Albanian public right where the city breathes.





NJË MBRËMJE ME MEDIAN PËR TË FESTUAR 20 VJETORIN E PORSCHE ALBANIA

A special evening with the media celebrating Porsche Albania's 20th anniversary

Në kuadër të festimeve për **20-vjetorin** e Porsche Albania, u organizua një mbrëmje e dedikuar për përfaqësuesit e medias shqiptare. Ky event special mblodhi së bashku gazetarë, redaktorë, krijues përmbajtjeje dhe bashkëpunëtorë afatgjatë në një atmosferë mirënjohjeje, rrëfimi dhe reflektimi mbi rrugëtimin e përbashkët.

Në një ambient të kuruar me kujdes, mbrëmja shërbeu si një falënderim për të gjithë ata që, ndër vite, kanë kontribuar në ndërtimin e imazhit, besueshmërisë dhe zërit të markës Porsche Albania.

Të ftuarit u rikthyen në momentet kyçe të historisë së Porsche Albania, nga hapat e para në treg, te rritja e vazhdueshme, inovacioni dhe angazhimi për të sjellë përvoja të nivelit premium. U ndanë kujtime nga fushatat dhe eventet më përfaqësuese të këtyre 20 viteve, si dhe një prezantim ekskluziv për vizionin e së ardhmes.


Mbrëmja u mbyll me një urim për të kremtuar bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe rrugëtimin që na pret ku besimi dhe inovacioni mbeten thelbi i misionit të Porsche Albania.

As part of the **20th anniversary** celebrations of Porsche Albania, a special evening was held to honor the longstanding partnership between the company and the media community. The event brought together journalists, editors, content creators, and long-term collaborators for a night of appreciation, storytelling, and shared milestones.

Hosted in an elegant and warm setting, the evening served not only as a moment of celebration but also as a sincere "thank you" to those who have consistently contributed to the visibility, credibility, and narrative of the Porsche Albania brand over the past two decades.

Guests were invited to revisit key milestones in Porsche Albania's history, from its early beginnings in the Albanian market to its continued growth, innovation, and commitment to premium automotive experiences.

The evening concluded with a toast to continued collaboration and a shared journey ahead where trust, and innovation remain at the heart of Porsche Albania's mission





ŠKODA ELROQ ZBULON TË ARDHMEN ELEKTRIKE ME NJË SURPRIZË MUZIKORE QË PREK NOSTALGJINË

Škoda Elroq brings the future of electric mobility with a nostalgic musical twist







Në një mbrëmje të dedikuar inovacionit, dizajnit dhe emocioneve të vërteta, Škoda Albania prezantoi për herë të parë në Shqipëri modelin elektrik **Škoda Elroq**, në zemër të rivierës shqiptare në Sarandë.

Eventi shënoi një hap të rëndësishëm për markën drejt mobilitetit të qëndrueshëm dhe elektrik, duke sjellë më pranë publikut shqiptar një **SUV kompakt dhe 100% elektrik**, me autonomi deri në 581 km dhe dizajn tërësisht të ri sipas filozofisë Modern Solid.

Të pranishëm ishin partnerë, klientë, figura publike dhe dashamirës të teknologjisë, të cilët patën mundësinë të përjetojnë nga afër performancën, dizajnin dhe funksionalitetin e Elroq.

Supriza e mbrëmjes? Një rikthim i pazakontë.
Në bashkëpunim me artistin **Alis**, Škoda solli një version modern të këngës ikonike të shoferit nga vitet '60 një himn i rrugëve shqiptare i cili tani i këndon Skodës së re. Një miks i muzikës retro me tingujt elektronikë të sotëm, që rikthen kujtime dhe hap rrugë për një brez të ri.

Kënga do të jetë pjesë e fushatës muzikore digjitale që shoqëron lançimin e Elroq në tregun shqiptar.

#BeMoreElroq

In an evening dedicated to innovation, design, and emotion, Škoda Albania proudly unveiled its newest electric model in the vibrant coastal city of Saranda.

The event marked a bold step forward in the brand's journey toward sustainable and electric mobility, showcasing a fully electric **compact SUV with up to 581 km of range**, built on the MEB platform and featuring Škoda's new Modern Solid design language.

Attendees including partners, clients, and public figures experienced the Elroq up close, engaging with its performance, technology, and intelligent design.

The highlight of the night? A nostalgic musical revival. In collaboration with Albanian artist **Alis**, Škoda reimagined the iconic 1960s "Driver's Song" a beloved road anthem — and gave it a fresh, electronic twist. The new version pays tribute to Škoda's legacy while embracing a new electric era.

The song will be part of the digital music campaign accompanying the Škoda Elroq launch in Albania.

#BeMoreElroq





ŠKODA ALBANIA & TURI ÇIKLISTIK I SHQIPËRISË 2025

Škoda Albania & Cycling Tour of Albania 2025

Škoda Albania përmbylli me sukses bashkëpunimin si partneri zyrtar i mobilitetit në **Turin Çiklistik të Shqipërisë 2025**.

Për pesë ditë me radhë, çiklistët më të mirë të vendit dhe botës garuan përgjatë etapave që lidhën qytetet kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë dhe Fier. Në këtë rrugëtim sfidues, Škoda ishte pranë sportistëve me modelet e saj të besueshme: Škoda Scala dhe Škoda Kodiaq, të cilat shoqëruan dhe mbështetën garën në çdo kilometër.

Ky bashkëpunim i rëndësishëm mes Škoda Albania dhe Federatës Shqiptare të Çiklizmit ka nisur për herë të parë para 18 vitesh dhe është kthyer tashmë në një traditë të qëndrueshme, duke reflektuar angazhimin e markës për mbështetjen e sportit dhe promovimin e sigurisë rrugore. Ne jemi krenarë që prej kaq shumë vitesh jemi pjesë e kësaj ngjarjeje të veçantë sportive. Për ne, ky partneritet shkon përtej aspektit komercial, është një mision që përfaqëson vlerat tona të përkushtimit ndaj komunitetit te çiklizmit dhe lëvizjes së sigurt

Škoda Albania successfully concluded its collaboration as the Official Mobility Partner of the **Tour of Albania 2025**.

For five consecutive days, Albania's and international top cyclists competed across key stages connecting the country's main cities: Tirana, Shkodra, Elbasan, Vlora, and Fier. Throughout this challenging journey, Škoda supported the athletes with its reliable models, the Škoda Scala and Škoda Kodiaq ensuring mobility and safety at every stage.

This longstanding partnership between Škoda Albania and the Albanian Cycling Federation began 18 years ago and has evolved into a solid tradition, reflecting Škoda's ongoing commitment to supporting sport and promoting road safety.

We are proud to have been part of this remarkable sporting event for so many years. For us, this partnership goes beyond a commercial collaboration it is a mission that embodies our brand values of the cycling community and dedication to safe mobility.



ŠKODA ELROQ RS EXPERIENCE NË PRAGË

Škoda Elroq RS Experience in Prague



Škoda Albania mori pjesë këtë muaj në Škoda Elroq RS Experience, një event ekskluziv i organizuar në Pragë, dedikuar modelit më të ri sportiv të markës: **Škoda Elroq RS**, SUV 100% elektrik, që kombinon dizajnin e ri Modern Solid me performancën e linjës RS.

Përfaqësues nga Shqipëria, **Anxhi Celiku** (ambasadore e markës), **Gentian Xhaferraj** (ekspert automotive), si dhe **Klejdi Kalaja** (fotograf dhe krijues kontenti i njohur), morën pjesë në këtë përvojë unike në Pragë, për të testuar performancën, teknologjinë dhe eksperiencën e drejtimit që ofron Elroq RS.

Gjatë dy ditëve të eventit, pjesëmarrësit patën mundësinë të testonin modelin Elroq RS në rrugët e Pragës dhe në pista të dedikuara testimi, duke përjetuar fuqinë e dy motorëve elektrikë, drejtimin sportiv, si dhe të gjitha teknologjitë e avancuara që ky model sjell në segmentin e SUV-ve kompakte.

Kjo pjesëmarrje është pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të Škoda Albania për të ndërtuar eksperienca reale rreth elektromobilitetit dhe për të sjellë për klientët shqiptarë modelet më të avancuara të gamës elektrike.

Škoda Elroq RS pritet së shpejti edhe në tregun shqiptar.

Škoda Albania took part this month in the exclusive Škoda Elroq RS Experience in Prague, an event dedicated to the brand's latest sporty model: Škoda Elroq RS a 100% electric SUV that combines the new Modern Solid design with the performance of the RS line.

Representing Albania, **Anxhi Celiku** (renowned content creator and brand ambassador), **Gentian Xhaferraj** (automotive expert and journalist), and **Klejdi Kalaja** (renowned photographer and visual creator), joined this unique experience in Prague to test the performance, technology, and driving feel of the Elroq RS.

During the two-day event, participants had the opportunity to test the Elroq RS on Prague's streets and dedicated test tracks, experiencing the power of the dual electric motors, sporty handling, and advanced technologies that this model brings to the compact SUV segment.

This participation is part of Škoda Albania's ongoing efforts to build real-world experiences around electromobility and to bring the most advanced electric models to Albanian customers.

Škoda Elroq RS will soon be available in the Albanian market.





ŠKODA ALBANIA SJELL NË SHQIPËRI ENYAQ IV TË RI

Škoda Albania brings the new Enyaq iV to Albania

Škoda Albania ka prezantuar në tregun shqiptar versionin më të ri të SUV-it elektrik **Škoda Enyaq iV**, të ridizenjuar me gjuhën e re vizuale Modern Solid. Ky model i përmirësuar ofron dizajn të avancuar, efikasitet të lartë dhe teknologji të fundit për një përvojë të përparuar në drejtimin elektrik.

Enyaq iV vjen me përmirësime të dukshme aerodinamike dhe teknologjike, që rrisin performancën dhe gamën e përdorimit të përditshëm. Një nga veçoritë kryesore është koeficienti i përmirësuar i rezistencës së ajrit, që arrin deri në 0.225 për versionin Coupé, duke optimizuar konsumin e energjisë.

Karakteristikat kryesore të modelit përfshijnë:

- Autonomi deri në 588 km për versionin SUV dhe 597 km për Coupé.
- Ngarkim i shpejtë DC deri në 175 kW, me mundësi karikimi 10–80% për 28 minuta.
- Interier modern, me material të qëndrueshëm dhe dizajn elegant sipas filozofisë “green & clever”.
- Asistencë e avancuar për drejtuesin dhe aplikacion MyŠkoda të përmirësuar për funksionalitete të zgjuara.

Përmes këtij modeli, **Škoda Albania** synon të fuqizojë më tej ofertën e saj në segmentin e automjeteve elektrike, duke u ofruar klientëve shqiptarë një përvojë drejtimi të avancuar, efikase dhe të qëndrueshme.

Škoda Albania has introduced the latest version of the all-electric SUV **Škoda Enyaq iV** to the Albanian market, redesigned with the new Modern Solid design language. This upgraded model delivers advanced styling, high efficiency, and state-of-the-art technology for an enhanced electric driving experience.

The Enyaq iV offers significant aerodynamic and technological improvements, increasing overall performance and everyday usability. One of the key highlights is its optimized drag coefficient, reaching as low as 0.225 for the Coupé version, ensuring optimal energy efficiency.

Key features of the model include:

- Driving range up to 588 km for the SUV and 597 km for the Coupé.
- Fast DC charging up to 175 kW, enabling 10–80% charging in just 28 minutes.
- Modern interior, with sustainable materials and elegant design in line with the "green & clever" philosophy.
- Advanced driver assistance systems and an upgraded MyŠkoda app offering smart connectivity features.

With this model, **Škoda Albania** aims to further strengthen its position in the electric vehicle segment, providing Albanian customers with an advanced, efficient, and sustainable driving experience.




SKODA
Hello, I'm Laura
Have a good journey!
No vehicle reports
Let's go home!
Start route guidance
100 m Breitcetlova
10:00
SKODA
ENYAQ
New Enyaq

KONKURSI “NGA QUATTRO NË KUADRO” EDICIONI II

“Nga Quattro në Kuadro” the second editon.

Audi Albania vazhdon traditën e organizimit të konkursit kreativ **“Nga Quattro në Kuadro”**, i cili këtë vit rikthehet në edicionin e tij të dytë, me disa risí që do të ngjallin interes të madh tek dashamirësit e artit dhe automobilizmit.

Pas suksesit të vitit të kaluar në fushën e fotografisë, ky edicion përfshin tashmë edhe kategorinë e videove, përveç asaj të fotografisë dhe përdorimit të inteligjencës artificiale (AI). Ky zgjerim i hap rrugë shprehjes artistike në formate të ndryshme, duke i dhënë mundësi pjesëmarrësve të eksplorojnë kreativitetin në dimensione të reja.

Konkursi do të zhvillohet gjatë muajve Qershor deri Gusht 2025, duke kulmuar në një një ekspozitë publike, ku do të prezantohen punimet më të mira dhe do të ndahen çmimet për fituesit e secilës kategori.

“Nga Quattro në Kuadro” është jo vetëm një konkurs arti, por edhe një platformë që lidh pasionin për automobilizmin me kreativitetin shqiptar, duke reflektuar frymën inovative dhe cilësinë që Audi sjell në çdo projekt.
More Creativity, More Innovation



Audi Albania continues its tradition of hosting the creative contest **“From Quattro to Frame”**, now entering its second edition with exciting new features that promise to inspire both art and automobile enthusiasts alike.


Following last year’s success focused on photography, this year’s edition expands to include a video category, alongside photography and artificial intelligence (AI) art submissions. This expansion opens new doors for artistic expression across different media, allowing participants to explore their creativity in fresh and dynamic ways.

The contest runs from June through August 2025, culminating in a public exhibition showcasing the best works and awarding winners in each category.

“From Quattro to Frame” is more than just an art contest, it’s a vibrant platform connecting the passion for automobiles with Albanian creativity, reflecting the innovative spirit and quality that Audi embodies in every project.

ELEGANCA GJERMANE NË RITMIN E NJË KAMPIONI

German elegance in the rhythm of a champion





Gentjan Shaqiri është një figurë e njohur, jo vetëm si pedagog i Fakultetit të Ekonomisë, por edhe si një kampion i vërtetë në sportin e automobilizmit. Me një pasion të thellë për shpejtësinë dhe precizionin, Gentjani u kurorëzua Kampion i Europës në FIA CEZ Hill Climb për vitin 2024, duke vendosur Shqipërinë në hartën e garave prestigjioze evropiane.


